VENDIM
Nr.84, datë 4.11.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "CEZ TRADE ALBANIA" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 13 pikat 1, germa "d", dhe 8 pika 2 germa "a" të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 10, pikat 1, dhe 3 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave ", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, germa "a", dhe 3 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 04.11.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "CEZ Trade Albania" sh.p.k. për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë "CEZ Trade Albania" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germa "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë "CEZ Trade Albania" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta